



## PROCESVERBAL X/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 10 (dhjetë) për vitin 2023 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

---

**Vendi:** KK Suharekë  
**Zyra:** Salla e Bordit të Drejtorëve  
**Data:** 17.11.2023  
**Ora :** 13:00

---

**Prezentë:**

**Z. Bexhet Kuçi - Kryesues**  
*z. Urim Suka*  
*znj. Bulëza Kuçi*  
*znj. Fidaije Kukaj*  
*znj. Sanie Kuçi Rexhepaj*  
*z. Dardan Berisha*  
*z. Liridon Fandaj*

**Të pranishëm tjerë:**

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore  
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim  
Përfaqësues i OSBE-së  
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

### **Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshimin e emërimit të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-4813 të datës 27.06.2013;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - kërkoj sqarime te pjesa ku thuhet: vendi i quajtur “fshat”.

**Kryesuesi** - po, në qertifikat shkruan kështu dhe në shumicën e certifikatave shkruan fshat.

**Urim Suka** - kërkoj sqarime nga drejtori te pjesa në përgjithësi. Sipas ligjit, të gjitha pronat publike ju duhet me i listu dhe me i publiku se cilat janë pronat publike që janë të gatshme për ti dhënë në shfrytëzim. Të gjitha pronat publike që i ka Komuna e Suharekës ,a i ka të listune dikund dhe a janë të publikuara? Pronat për vitin 2023-2024 a janë dikund të publikuara që kanë me u dhënë në shfrytëzim?

**Armend Krasniqi** - lokalit të cilin e kemi sjell për dhënie në shfrytëzim, faktikisht i kemi tejkalu disa afate ligjore sepse kemi pas të gjetura të auditorit. Zyrtarisht Komuna e Suharekës e ka vetëm një lokal. Sa i përket listës, të gjitha pronat janë të publikuara në faqen e Komunës dhe çdo gjë rreth pronave.

**Avni Bytyqi** - për vitin 2024 deri më 31.12.2023 Komuna ka afat ligjor për me publiku listën e pronave të cilat pretendon ti jap në shfrytëzim në vitin 2024. Komunës i takon që ta publikojë listën e përgjithshme të pronave publike të komunës dhe listën e veçantë të cilat pretendon që vitin vijues ti jap në shfrytëzim .

**Liridon Fandaj** - ata që janë deri tash qiramarrës aktual dhe e kanë zbatu një kontratë, a janë të favorizun në ankand publik? Nëse një person e ka pas 23 vjet dhe çdo herë i ka pagu obligimet ndaj Komunës, duhet të paktën me pas një përparësi.

**Armend Krasniqi** - ligji për dhënie në shfrytëzim e specifikon saktësisht dhe nuk lejon të drejta të favorizorizohet çoftë ai që e ka pas apo çoftë të tjerët.

**Avni Bytyqi** - drejtori nuk ka kompetencë dhe as autoritet që ta favorizojë dikë për arsye se ka qenë qiramarrës deri më sot apo ka. Komisioni e vlerëson se a donë ti jap prioritet dikujt apo jo mirëpo siq tha edhe drejtori, në bazë të ligjit nuk lejohet.

**Liridon Fandaj** - nëse dikush e merr një kontratë një vjeçare dhe atë kontratë si Komunë ia ke dhënë në shfrytëzim për një vit por nuk ia ke shkëput. Ai ndoshta e ka bërë një investim kapital dhe tash nëse dikush konkurren me një çmim më të lartë sepse favorizim është çmimi më i madh. Nuk dua ta favorizoj dikënd por të paktën me dëmtu dikënd nuk bën.

**Avni Bytyqi** - për të gjitha kontratat që nënshkruhen nga Komuna me operatorët, në asnjë dispozitë ligjore të kontratës nuk thotë që pas mbarimit të kontratës pronarit do ti konopenzohen investimet që i ka bërë. Ai e merr në rrezik n'vete. Ligji për prokurim publik nuk e lejon që ta favorizojë dikënd. Në çështjen e procesit të marrjes pjesë së ankandëve publike kur Komuna shpreh interesin për me dhënë në shfrytëzim një pronë

**Urim Suka** - unë e lexova ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronave publike dhe brenda asaj që lexova pashë që ishin tri forma se si Komuna mund ti jap në shfrytëzim pronat. Komuna shpall ankand publik, interes publik dhe ishte me negociim përmes Kryetarit të Komunës. Temën që e ngriti Liridoni është temë që duhet të merret seriozisht. Pronari që e ka atë pronë vazhdimisht ka qenë i përgjegjshëm. Brenda ligjit që unë e kam lexu, është e mundshme që me negociim me u krye kjo punë dhe veq me na ardhë neve në Asamble për me u dhënë pëlqimi.

**Avni Bytyqi** - vërtetë ligji i parasheh tri procedura: të ankandit publik, interesit publik dhe negociimit mirëpo Kryetari i Komunës ka të drejtë vetëm atëherë kur vlera investive që pretendohet me u investu nga operatori i cili kërkon të negociohet, është 10% e vlerës investive kapitale. Kjo nënkupton që këtu njeri prej kritereve nuk e plotëson që Kryetari të hyn me negociata për këtë çështje. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Urim Suka** - Komuna nuk ka vepru me kohë dhe për shkak të kësaj po i bie që ne nuk jemi duke e mbrojtë interesin publik në mënyrën më të mirë të mundshme, se me një anë duhet me u mbyll një lokal, një anë tjetër ne duhet mos me i marrë ato të hyra deri të kryhet procedura dhe vendimet që po i marrim ne tash jemi duke i kriju humbje Komunës. Nuk e di a ka naj bazë ligjore që këtë humbje Komunës mos me ia kriju.

**Armend Krasniqi** - ligji për dhënie në shfrytëzim e thotë që prona duhet me qenë e lirë për procedurat e dhënies në shfrytëzim.

**Urim Suka** - ky është i përgjegjshëm dhe nuk është uzurpator. Me gabimet tona si Komunë që nuk i kemi ndjek procedurat me kohë, ne jemi duke e dëmtu operatorin ekonomikë por edhe interesin publik të Komunës. A ka bazë ligjore për me ia mundësu një aneks kontratë atij?

**Armend Krasniqi** - te ligji po kemi mungesë të saktësisimit të kësaj procedure. Dje e kam kërku një sqarim nga agjensioni kadastral se si të veprohet. Po ashtu kam bisedu me drejtorin e agjencionit kadastral, kishin disa raste të cilat e kishin shfrytëzu këtë periudhë deri sa ka zgjat ankandi publik dhe besoj që ma kthejnë një email zyrtare. Drejtori tutje jep sqarime.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshimin e emërimit të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën 3 dhe hap debatin.

**Dardan Berisha** - këtu janë disa shkolla të cilat janë paralele të ndame por edhe shkollat tjera që janë në gjuhën serbe këtu, desha të dijë se si kanë ekzistua ose në çfarë rregulla janë bazu deri tash shkollat tjera?

**Avni Bytyqi** - emërtimin e shkollave e bën ministria e Arsimit me kërkesën e Komunës duke i marrë propozimet nga këshilli i shkollës. Kështu është bërë ndarja fizike e shkollave paralele. Kërkesa ime kur ka fillu kjo procedurë ka qenë që me i bashkëngjit të gjitha vendimet e sekretarit të Ministrisë së Arsimit për emërtimin e shkollave aktuale për të cilat pretendohet me bërë ndryshimin aktual të gjendjes faktike me gjendjen reale në teren te shkollat mirëpo DKA nuk ka mujt me i gjet këto dokumenta apo si ka sjellë, nuk kam informacione.

**Urim Suka** - me sa po e shoh shkollat e kanë ndërru emrin por problemi është që prona me kalu në emrin e ri. Është një vendim që ne duhet me marrë dhe është i vonuar.

**Kryesuesi** - ka më shumë se dy vite që kjo është duke u laku për me u kry. Avni u potencoi që zgjidhja më e mirë ka qenë në atë formë mirëpo nuk ka qenë e mundur mu gjetë dokumentacioni nëpër arkiva dhe për këtë arsye janë vonu.

**Urim Suka** - iniciativa është e shkollave. Lexon kërkesën. Sido çoftë është një punë e mirë që po bëhet.

**Visar Kuçi** - çdo mbledhje të bordit na ka përcjell ky problem për shkak se nuk jemi pais me dokumente të shkollës. Kemi dasht me bo një investim në shkollën e Greikocit dhe na ka dalë emri i shkollës së Gjinocit. Jemi konsultu disa herë me jurista dhe më së shumti janë marrë me këtë Avni, Armendi dhe drejtori i Arsimit. Drejtori tutje jep sqarime.

**Armend Krasniqi** - jep sqarime sa i përket inicimit të kësaj pike dhe thotë që dy vite ka që është inic u kjo procedurë. Drejtori tutje jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - dua ti kritikoj kolegët që janë në arsim se pse nuk e kanë ngrit çështjen më herët. Në kuadër të kësaj kisha dasht që secila shkollë me pas kufizimin e parcelës që i takon që mos me pas probleme prap me qertifikata kur të ndryshohen.

**Avni Bytyqi** - në zyrën time gjenden të gjitha certifikatat për 30 shkollat dhe skica e terrenit.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

### Unanimisht Miratohet

#### **Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-4813 të datës 27.06.2013;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - sa i përket vendimit është pak paqartësi. U bë një këmbim i pronave mes Komunës dhe personave juridik. A ka ndodh ai investim sepse kur u bë kjo është bë për shkak të rrugës. Kërkoj sqarime.

**Armend Krasniqi** - E kemi përpilur një dokument shtesë për me sjell në Asamble dhe me rregullu çështjen e këmbimit të pronës. Këmbimi është në të njëjtin vend. Ne po dojmë me marrë rrugë ku është interesi i çdo qytetari të Mushtishtit me kalu në atë rrugë ndërsa po dojmë t'ia këmbejmë shumë afër të njëjtat metra që na ka dhënë ai. Mirëpo këtu ka qenë vetëm një mos përputhje e numrave që u bë në 2013 dhe këtë me shumë mund e kanë rregullu gjeodetat e Komunës së Suharekës.

**Urim Suka** - do të thotë investimi u bë, rruga ka ndodh dhe vetëm prona ka mbet me u rregullu.

**Armend Krasniqi** - po, rruga është funksionale.

**Urim Suka** - në kuadër të ligjit për dhënien e pronave në shfrytëzim, aty është një pikë ku thotë që Komuna kur e jep një pronë në shfrytëzim, ai e bën një kontratë me atë. Brenda 6 muajve Kryetari me raportin që duhet me bo, çdo 6 muaj i raporton Asamblesë për funksionimin e këtyre kontratatave. Mirëpo ne në asnjë rast nuk kemi pas një raport të Kryetarit. Është mirë që Kryetari të na raportojë në mënyrë që me pa gjendjen se çka po ndodhë me të gjitha kontratat që i kemi dhënë në shfrytëzim dhe gjithashtu për pronat që i japim nesër, pasnesër. Ajo që me shqetëson mua është se pse ligji nuk është duke u zbatu.

**Kryesuesi** - në 2013 kur është bë ndërrimi ka qenë vetëm një parcelë me një numër. Tani vllaznia janë nda dhe sicili i ka marrë nga 200 m<sup>2</sup> dhe duan ta kenë secili numrin e vet.

**Liridon Fandaj** - nuk besoj që është ky problemi.

**Avni Bytyqi** - në 2013 është drejtu rruga në Mushtisht dhe i ka prek 200 m<sup>2</sup> prona private dhe 200 m<sup>2</sup> është lëshu prona publike anën tjetër. Ne kemi marrë vendim me këmbi pronën publike në pronë private. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime dhe thotë që qëndron ajo që tha Kryesuesi.

**Liridon Fandaj** - në momentin kur është marrë vendimi, nëse u bë këmbimi i pronës, nuk ka mundësi me ndërru ashtu si thotë Avni. Vendimin e 2013-tës duhet me shfuqizu dhe jo me ri formulë.

**Avni Bytyqi** - janë shënimet në kadastër.

**Liridon Fandaj** - a ka pëlqim prej pronarëve?

**Avni Bytyqi** - po, avokati e ka sjell kërkesën.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Dardan Berisha** - të njëjtën ditë kur është shfuqizu ky vendimi,ti ke propozu automatikisht me formu një komision të ri dhe aty nuk u dha asnjë propozim prej subjekteve politike.Tash e keni sjell prap vendimin për me formu komisionin. A kanë të drejtë me qenë krejt të një subjekti?

**Kryesuesi** - nëse s'ka prej opozitës,prap kërkoj që të formohet ky komision.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - herën e kaluar ka qenë e pa pritur për shkak se vetëm unë kam dhënë dorëheqje dhe anëtarët tjerë kanë dhënë dorëheqje aty për aty dhe partitë politike kanë qenë pak të pa përgatitura që secili me dhanë propozimin.

**Kryesuesi** - unë kisha kërku me formu komisionin dhe me zgjidh këtë problem sepse është stërzgjatë.

**Liridon Fandaj** - ky komision dy herë ka dështu prej ekzekutivit dhe mos ia leni Kuvendit.Sot operatori ekonomikë i ka të shpenzune 50.000€ dhe nëse ai bën padi kundër Komunës,kush është përgjegjës për këtë?

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - a e ke ndëgju najher historinë që sa herë e kam tregu në Asamble se pse ka dështu si proceduë mandatin e kaluar?Herën e kaluar ka dështu për shkak të vet operatorit.Ndoshta as tash nuk ka me pranuar,atë nuk e dimë.

**Liridon Fandaj** - komisioni duhet me dhënë një verdikt dhe a i pëlqen apo jo është tjetër gjë.

**Kryesuesi** - ia ka dhënë verdiktin.Mandatin e kaluar dhe tash kanë dhënë maksimumin për me kry.

**Dardan Berisha** - edhe unë kam qenë anëtar i komisionit.Ai ka kërku me ia konpenzu lokalin por ne nuk mund të nënshkruajmë diçka që del jasht rregullores.

**Liridon Fandaj** - nëse një anëtar i komisionit të LDK-së nuk ka marrë pjesë asnjëherë,është dasht Kryesuesi me kërku me zëvendësu.Në momentin e fundit Sania jep dorëheqje.

**Avni Bytyqi** - komisioni duhet me njoftu me kohë.Nëse dy seanca nuk merrë pjesë duhet me ndërru.

**Visar Kuçi** - Liridoni përmendi që e kemi marrë pagesën.Është fakt që e kemi marrë pagesën mirëpo në marrëveshje me palën u bë pagesa dhe lënda është e pezullune për shkak se pala s'mund të paiset me leje pa u bë ndarja e hapësirave.I lus partitë politike që ta qesin nga një anëtar të asamblesë dhe të vazhdojmë me procedura.Te pika 2.2 komisioni i kaluar e ka pas një plotësim-ndryshim të vendimit.Investitori i ka paraqit dy lokale të përkohshme që i ka ble,toka është e Komunës por objekti është i tij.Në plotësim ndryshimin e vendimit të kaluar e ka sqaru Asamblea që janë dy banesa por pala po pretendon që i ka lokalet e përkohshme.Mund ti dalë prapë problem komisionit të ardhshëm.Drejtori tutje jep sqarime sa i përket këtij problemi dhe thotë që prap pala mund të mos pajtohet dhe të zgjasë si lëndë.

**Liridon Fandaj** - ti je i thirrur me mbrojtë interesin publik dhe e din versionin tënd dhe a do me marrë apo jo ai,ti nuk e dëmton Komunën.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - Komisioni që del prej Kuvendit e ka për obligim me nënshkru një marrëveshje me investitorin dhe ajo marrëveshje me ardhë në Kuvend.Nuk vjen kurgja në Kuvend pa u nënshkru marrëveshja.

**Liridon Fandaj** - nuk e nënshkru ai dhe ti e bje që nuk u nënshkru.Nuk merresh më me atë procedurë.

**Visar Kuçi** - Komuna e ka dhënë pronën në shfrytëzim për ndërtim dhe shëndrrimin e lokaleve që i takojnë Komunës.Komuna do të i shëndrroj në banesa dhe ky komision e ka për detyrë shëndrrimin e lokaleve në sipërfaqe aq sa i takojnë Komunës lokale,me i shëndrru në banesa.Për veq kësaj komisioni e ka edhe një kompetencë tjetër.Njëri prej pronarëve i ka të blene dy banesa dhe komisioni e ka për detyrë me ia konpenzu ato banesa në objektin e ri.Kur pronari i ka ble ato banesa,ligji ia ka leju me i shëndrru banesat në lokal të përkohshëm.Banesën e ka në përdhesë dhe tregu dallon,përdhesa me katin e tretë.

**Avni Bytyqi** - Komuna kur ta merr pronën e vet, e kthen. Ka me ia konpenzu dikuj, ia kompenson. Nëse e ke banim katin e parë,katin e parë ka me ta konpenzu metër për metër.Nës e ke lokal afarist katin e parë ka me ta konpenzu metër për metër. Dhe jo,ti e ke banim dhe tash pe don katin e parë lokal afarist.Jo, sepse Komuna ka interes me bo dy kate afarizëm.

**Urim Suka** - ne pak a shumë po i përziejmë me interesa të ngushta. Ne e formojmë një komision dhe komisioni e ka për detyrë me i përmbush detyrat. Komisioni kur të formohet duhet me kërkua një ekspert ose dikënd me licencë që bën barazvlerën e tyre, ai me lëshu një raport dhe m'i ja dhënë komisionit dhe mbi bazën e atij raporti ju pastaj me vendos. Dhe nëse palës nuk i pëlqen, ti nuk mund ta dëmtosh interesin e Komunës. Nëse aty është prona lokal, ne kemi me i dhënë lokal. Nuk mundemi ne me ia dhënë 1 m lokal dhe me ia marrë 1 m banesë sepse metra e lokalit shkon 1 me 3 ndoshta dhe kjo është arsyeja pse anëtari jonë nuk ka marrë pjesë.

**Visar Kuçi** - a mundemi me diskutu pikën 2.2 sepse ne prap mund të mos kryejmë punë. P.sh. një prej propozimeve ka qenë që investitori që i ka marrë 80 m<sup>2</sup>, ashtu si iu ka marrë shëndrrimi i lokaleve në banesa, njëri prej propozimeve ka qenë edhe shëndrrimi i këtyre lokaleve ku ne si komision i kemi marrë për banesë por ia kemi propozu shëndrrimin në lokal.

**Urim Suka** - si ka qenë propozimi?

**Visar Kuçi** - me një koeficient 1 m<sup>2</sup> lokal me 1.7 m<sup>2</sup> banesë. A mundemi me cek në vendim që lejohet shëndrrimi.

**Kryesuesi** - ju si komision e sjellni këtë vlerësim.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - është vështirësi e punës së komisionit. Është shumë më mirë kur të tëra definohen me vendim të Asamblesë. Liridoni po mendon që kjo punë është çështje e drejtorisë së urbanizimit. Çështja është komplet e Kuvendit. Drejtorja e Urbanizimit pret vendimin final të kuvendit kur po i vje marrëveshja e përfundune. Mirë është me u inkuadru në vendim. Asnjë metër katror nuk i lun Komunës sepse është shëndrrim.

**Avni Bytyqi** - çfarë interesi ka Komuna?

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - Komuna është duke marrë banesa.

**Avni Bytyqi** - ti po i shëndrron lokalet tua afariste në banesa e pastaj po ndodh e kundërta.

**Liridon Fandaj** - duhet me bë edhe një analizë financiare.

**Visar Kuçi** - komisioni i ardhshëm mund të kërkoj ekspert të vlerësimit të pronës por edhe të vlerës financiare. Te pika 2.2 mos të përmendet emri banesë por le të përmendet emri pronë me sipërfaqe kaq metra katrorë.

**Avni Bytyqi** - banesë ka ai dhe jo pronë dhe nuk mund të hyjë Kuvendi në lajthitje.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - e votojmë por mua më vje keq sepse ky vendim ka me ardhë prap për plotësim ndryshim.

**Kryesuesi** - jasht vendimit që e ka ai ne nuk mund të bëjmë asgjë.

**Visar Kuçi** - ai i ka 85 m<sup>2</sup> banesë dhe ai po pranon me ia shëndrru në 50 m<sup>2</sup> lokal. Çka i prish punë Komunës?

**Kryesuesi** - atëherë vlerësone ju komisioni.

**Sanie Kuçi Regjepaj** - nuk e ka detyrë komisioni.

**Urim Suka** - nëse tema për të cilat çështja ka mbet pezull nuk janë detyra të punës në atë vendim, unë mendoj që duhet të futen detyrat e punës në këtë vendim.

**Avni Bytyqi** - janë detyrat e punës. Këta po dojnë detyra shtesë sipas kërkesës së palës.

**Urim Suka** - Edhe pala edhe Komuna kanë interesa. Këto interesa që po diskutohen është një komision që duhet me i trajtu. Ky komision mos me vendos qysh don vet por nëse s'është kompetent duhet me thirr një ekspert të licencun.

**Avni Bytyqi** - nëse mendoni me bë ekspert të licencuar, i bën Kuvendi dhe nuk ka nevojë me formu komision mbi komision. Nëse doni ashtu, Kuvendi le të bëj ekspert të jashtëm.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 5.

**4 për, 3 apstenime  
Miratohet pika 5**

Takimi përfundoi: 14:20

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj